



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:242090
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05450633

C.nr. 1391/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin individual Fuad Haliti, në çështjen juridike të paditëses A.K.G nga Mitrovica, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. Lutfi Tahiri, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, baza juridike, kompensim e pagave shtesë ne emër të licencimit, më datë 14.03.2024, jashtë seancës gjyqësore nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. **APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE** me numër C.nr.1391/23 e datës 26.12..2023 (Nd:566/2023) e arritur në procedurën e ndërmjetësimit, në mes të paditëses A.K.G dhe të paditurës Komuna e Mitrovicës dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv-përmbarues.

Arsyetim

Paditësja A.K.G me datën 31.10.2023 pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi për kompensimin e pagave shtesë ne emër të licencimit.

Me datën 26.12.2023, gjykata është njoftuar se palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit pranë ndërmjetësueses të licencuar Adelina Sh. Spahiu e cila këtë marrëveshje me shkrim i'a ka dorëzuar gjykatës.

Gjykata, pas analizimit të shkresave të cilat gjinden në lëndë konsiderojë se janë plotësuar kushtet për aprovimin e kësaj marrëveshje të arritur në procedurën e ndërmjetësimit dhe vendosi si në Sipas nenit 15 paragrafi 4 i Ligjit për Ndërmjetësimin *“Nëse Ndërmjetësimi fillon me vetëinicimin e palëve, marrëveshja e arritur me shkrim e nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi, e cila përmban klauzolën (vërtetimin) mbi plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjes, ka fuqinë e dokumentit përmbarues në përputhje me ligjin përkatës për procedurën përmbarimore.”*

Prandaj, gjykata, bazuar në arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 15 paragrafi 4 të Ligjit për ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.1391/23, me datë 14.03.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet e drejta në ankesë.